



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Tergovine/
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade**

Bazuar në nenin 79 dhe 80 të Ligjit Nr.06/L - 114 për Zyrtarët Publik, Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe Rregullores (QRK) Nr. 05/2022 Për Procedurat e Konkurruese dhe Pranim Për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, shpall:

KONKURS PUBLIK

Titulli i Vendit të Punës:	Vozitës (1 pozitë)
Koeficienti:	3.88
Lloji i pozitës:	Nëpunës administrativ dhe mbështetës
Kohëzgjatja e emërimit:	Në afat të pacaktuar
Njësia Organizative:	Departamenti për Shërbime të Përgjithshme / Divizion për Transport dhe Logjistik
Raporton tek:	Udhëheqës i Divizionit për Transportit dhe Logjistik
Data e njoftimit:	15/06/2023
Afati për aplikim:	30/06/2023 – 07/07/2023
Orari i punës:	I plotë
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve të vozitjes së zyrtarëve dhe stafit të institucionit, duke e koordinuar punën me eprorin e drejtpërdrejtë lidhur me obligimet për vozitje.

Detyrat dhe përgjegjësisë:

1. Ofron shërbime të vozitjes dhe të transportit për personelin e Institucionit, lidhur me kryerjen e punëve zyrtare sipas kërkesave dhe nevojave;
2. Kryen shërbimet e rregullta të mirëmbajtjes së automjetit zyrtar duke u kujdesur dhe kontrolluar automjetin për derivate, për vaj, për ujë, antifriz, goma dhe funksionalitetin e automjetit në çdo pikëpamje;
3. Mbanë evidencën e porositë të punës dhe për servisim të automjetit;
4. Mbanë evidencën dhe përgatitë raporte për kilometra të kaluara në baza ditore, javore dhe mujore, me mbajtje të evidencës së kërkesave për automjet zyrtar;
5. Mbanë evidencën e kërkesave për automjet zyrtar;
6. Ndhmon zyrtarët dhe kujdeset për çështjen e nevojave të tyre për transport;

7. Përgjegjës në respektimin e orarit të punës, për përdorim të automjetit dhe respektim të Kodit të Etikës, Kodin e SHC dhe rregulloreve tjera që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve;
8. Kryen detyra tjera të caktuara nga eprori i drejtpërdrejtë të cilit i raporton.

Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos jetë i dënuar apo nën hetime;

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi

- Shkollim i mesëm;
- Posedim i patentë shoferit për kategorinë "B".

Përvoja e punës

- Së paku tri (3) vite përvojë pune si vozitës.

Njohuritë, shkathtësitë, aftësitë për vendin e punës:

- Njohuri të nevojshme profesionale për kryerjen e detyrës së vozitësit;
- Shkathtësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioritetëve;
- I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
- Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion;
- Të ketë reagim të duhur në zgjidhjen e problemeve;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, në përdorimin e kompjuterit, veçanërisht programeve MS Word;
- Njohuri të mira të gjuhës shqipe, ndërsa njohja e gjuhës serbe dhe angleze është përparësi.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Diplomë
- Certifikata e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmia e patentë shoferit;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Certifikata që nuk është i dënuar apo nën hetime;

Informatë e përgjithshme për gjithë kandidatët :

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e njoftimit të konkursit në portalin shtetëror www.konkursi.rks-gov.net është me datë 15/06/2023, pranimin e aplikacioneve është tetë (8) ditë përkatësisht nga data 30/06/2023 deri me 07/07/2023.

Përveç portalit shtetëror www.konkursi.rks-gov.net, konkursi si dhe aplikacioni publikohet edhe në web. faqen e MINT <https://mint.rks-gov.net>

Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë "Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publik"

Paraqitja aplikacioneve: Aplikacionet dorëzohen me pliko/zarf në Njësinë e Burimeve Njerëzore në MINT
Adresa: Rr. “Arbënor dhe Astrit Dehari” Nr.23 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 36 -578.

Aplikacionet e dërguara përmes postes, me pullë postare në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen te vlefshme.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.